

RELACION TEKNIK

Objekti: **NDËRTIM SHPATULLA E KËMBZA URE (PËR URË BEJLI), MBI PËROIN E PRODIT (LIDHJA E FSHATRAVE PRODAN-GJONÇ), BASHKIA KOLONJË VITI 2026**

Përshkrimi i projektit

Ky projekt parashikon ndërtimin e shpatullave, speratoreve prej b/a, mure mbajtës prej gabioni të urës BEJLI (BAILEY) në përroin e fshatit Prodan e cila do i shërbejë aksit rrugor Prodan-Gjonç.

Projekti do të realizohet në bashkëpunim mes bashkisë Kolonjë e cila do realizojë ndërtimin e shpatullave, speratoreve, mure mbajtës prej gabioni dhe Ministrisë Mrojtjes (Batalioni Xhenjos) e cila mer përsipër furnizimin dhe montimin e ures BEJLI (BAILEY) me gjatësi 36m dhe seksion tërthor 2/1, gjerësi të kalueshme 4.6m me aftësi mbajtëse 18 ton në kalimin e automjeteve (ura nuk do kete këmbza në mes, pasi përroi është i rëmbyshëm).



Tipi i urës BEJLI (BAILEY)

Tipi i urës së propozuar është realizuar në një tjetër bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (Batalioni Xhenjos) në fshatin Qafëzes me gjatësi 18m, seksion 2/1 me gjerësi të kalueshme 4.6m

Përshkrimi teknik i projektit

Implementimi i këtij projekti ka si qëllim të bëjë të mundur shfrytëzimin e rrugëve të fshatrave edhe në rastet e motit me reshje e shtërngata shiu.

Për këtë qëllim parashikohen punimet si më poshtë:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA
		1. PUNIME GERMIMI		
1	3.96/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 1m, kategoria III, me shk ne toke (themelet e		

		shpatullave, muret mbatës e rakordues, trase rruge)	m3	207
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	207
3	3.159/a	Germim e trasport dheu kat II-te me skreper, L=100m dhe V=6~6.5m3 (në rrugë e shtratin të përroit)	m3	133.21
		2. PUNIME HEKUR BETONI 3		
4	3.287	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1.8
5	3.288	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	ton	3.15
		3. PUNIME BETONI E BETONARMEJE		
6	3.241	Struktura te holla monolite betoni C 12/15	m3	12
7	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	198
		4. PUNIME TE NDRYSHME		
8	3.624	H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum (muret b/a para mbushjes)	m2	150
		5. PUNIME SHTRESASH		
9	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	250
10	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	82
11	3.198	Cilindrim kasonete me rul	m2	620
		6. PUNIME SHTRESASH		
12	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	44
13	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	16.5
14	3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	m3	11


Vendndodhja dhe ndërtimi i veprës

Parashikohet që ndërtimi i veprës të zhvillohet në një kantier me vendodhje sim ë poshtë:







PRERJA SIPAS AKSIT TË URËS SHK. 1 : 200




PRERJA 1 - 1 E SPERATORËVE SHK. 1 : 100




PRERJA 2 - 2 E MURE SHK. 1 : 100




PRERJA SIPAS AKSIT TË URËS SHK. 1 : 200



PRERJA 1 - 1 E SPERATORËVE SHK. 1 : 100



PRERJA 2 - 2 E MURE SHK. 1 : 100



FOTOMONTAZH I GJËNDJES EKZISTUSE



Për vendosjen e urës BEJLI bashkia Kolonjë komunikon me Ministrinë e Mbrojtjes sipas akt-marveshjes së nënshkruar mes tyre.

Siguria në Kantier përfshirë Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier, menaxhimin e trafikut dhe kontrollin

Sigura she shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit të punëmarrsve, nëpërmjet parandalimit të reziqeve profesionale, eliminimin e faktorve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesmarrjen e balancuar si dhe trajnimin dhe formimin e punëmarrsve e përfaqësuesve të punëmarrsve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Kjo rubrikë merret si detyrim ligjor nga sipërmarsi.

“Siguria në kantier” shërben për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrsve në mënyrë që të zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrsve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Theksohet se, nga monitorimi i specialistve të HSE dhe/apo Mbikqyrësit të Punimeve rezulton nuk janë zbatuar masat e sigurisë në kantier (kjo nënkupton edhe në se ka një shkelje të vetme) do të ketë masa penalizuese referuar KPK dhe KVK të Kontratës.

Impakti i investimit

Sigurimi i lëvizjes së automjeteve dhe këmbësorve dhe në rastin e reshjeve e stuhive atmosferike.

Ritja e sigurisë rrugore.

Përmirësimi i aksesit në rrugët e fshatrave.

Lidhja e fshatrave me rrugë auto dhe reduktimi i kohës me akset kombëtare e qendrat administrative.